



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 159/ 2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HEDHET** si i palejuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) e datës 08.06.2017

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 08.06.2017 ka pranuar një ankesë nga KDI ne te cilën theksohet se me datën 08.06.2017 ne rrjetin Youtube ne linkun <https://www.youtube.com/watch?v=0w8>, është publikuar spoti publicitar i subjektit politik Gragjanska Iniciativa Serpska Lista i cili spot përmban gjuhe të urrejtjes dhe ka imazhe kundër kushtetutës se Republikës se Kosovës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejushmërisërisë së apelit gjeti se:

### Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës gjeti se ankesa e parashtruar nga KDI, ku është e njëjtët si në aspektin subjektiv dhe atë përmbajtjesor me ankesën e parashtruar nga BIRN dhe Internews Kosova Anr.120/2017 e datës 07.06.2017, për të cilën PZAP-i , ka vendosur me vendimin Anr.120/2017 të datës 08.06.2017. Prandaj nisur nga kjo gjendje faktike rezulton për ankesën e parashtruar nga KDI, është çështje e vendosur me vendimin e lartpërmendur dhe vlerësohet si çështje e gjykuar.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e në pajtim me dispozitat e nenit 11 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 159/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha

Prishtinë / Priština

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

